




## INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



### SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2025/2026 (JAVA 43-TË)

#### Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fytë
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




#### PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,  
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikoni 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njejtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026  
DHE PRAGU EPIDEMIK**


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 29 tetor 2025 (java e 43-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 4,519 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 1,011 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 3 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 43-të (20.10.2025-26.10.2025) janë raportuar 1,285 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 245 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 3 raste me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 413 raste ILI dhe 5 raste ARI.


**Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 43-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rritje prej 19.86%. (Graf.2)**


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës, Mitrovicës, Pejës dhe Suharekës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atkuar është 0-4 vjeç (671 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (144 raste), 15-64 vjeç (135 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (61 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




## MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri me 29 tetor 2025, janë testuar gjithsej 657 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 330 (50.22%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 327 (49.77%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 15 raste (4.54%). Nga 327 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 3 raste me Influcencë A (pozitiviteti 3.66 %). Rastet e konfirmuara me Influcencë A janë nga komuna e Prishtinës (1 rast), Ferizaj (1 rast) dhe Viti (1 rast) dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (2 raste) dhe 5-14 vjeç (1 rast). Gjatë javës së katërdhjetë e tre (20.10.2025-26.10.2025), nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 56 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 21 mostra me RSV, 86 mostra me Human Rhinovirus, 47 mostra me Human Adenovirus dhe 10 mostra me Parainfluenza Virus (Graf.5).


Rastet pozitive në RSV (6.4%), janë nga komuna e Prishtinës (12 raste) dhe Fushë Kosovë (8 raste) dhe Gjilan (1 rast) dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (17 raste), 5-14 (2 raste), 35-50 (1 rast) dhe 65+ (1 rast) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3 është konfirmuar një rast apo 33% dhe me subtipin AH1N1 janë konfirmuar 2 raste apo 67% (Graf.6.)

Grafikoni. 6



## AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcës.

Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësor që të ngrisin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Ka rekomanduar tek Inspektorati shëndetësor të mbikëqyrë të gjitha Institucionet shëndetësore të Kosovës, për të urdhëruar për obligimin ligjor të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse dhe rasteve të vdekjeve nga këto sëmundje.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

## MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe huthja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

### **Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut**

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

## VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale) dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 15 tetor janë administruar gjithsej 25,642 doza të vaksinës kundër gripit sezonal.

## HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 32 raste me ARI, 3 raste me ILI dhe 3 raste SARI.

## SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

### INFLUENCA SEZONALE JAVA 43/2025 NË EVROPË

Gjatë javës së fundit, në Rajonin Evropian të Organizatës Botërore të Shëndetësisë është vërejtur një rritje e lehtë e aktivitetit të sëmundjeve respiratore. Aktiviteti i sëmundjes së ngjashme me gripin (ILI) dhe infeksioneve akute respiratore (ARI) kanë tejkaluar nivelin bazë në gjashtë nga tridhjetë e një shtete dhe zona që kanë raportuar të dhëna. Edhe pse aktiviteti i gripit mbetet nën nivelin e pragut epidemik për këtë sezonë, ai është rritur gradualisht gjatë javëve të fundit, duke reflektuar një rritje të qartë të transmetimit në disa vende të pjesës perëndimore të rajonit. Aktiviteti i virusit SARS-CoV-2 në nivel rajonal paraqet një tendencë të përgjithshme në rënie, megjithëse me ndryshime të dukshme midis vendeve. Varianti XFG vazhdon të dominojë në qarkullim në të gjithë rajonin, ndërsa përqindja e mostrave pozitive për SARS-CoV-2 mbetet në të njëjtin nivel si një javë më parë, rreth 13%. Në të kundërt, aktiviteti i virusit respirator sincicial (RSV) mbetet në nivele ndër-sezonale dhe nuk janë raportuar shenja të rritjes së parakohshme të qarkullimit. Sa i përket aktivitetit të gripit, tri vende – Franca, Kazakistani dhe Malta – raportuan norma të ILI mbi nivelin bazë, ndërsa Gjermania, Lituania dhe Spanja raportuan rritje të normave të ARI. Nga të gjitha mostrat e marra në qendrat sentinel, vetëm 5% kanë rezultuar pozitive për virusin e gripit, një rritje e lehtë krahasuar me javën e kaluar, por ende nën pragun epidemik prej 10%. Norma e pozitivitetit për vendet raportuese ishte 1%, me dy rajone të Mbretërisë së Bashkuar – Skocinë dhe Irlandën e Veriut – që raportuan përqindje më të larta (21%). Analizat virologjike tregojnë se pothuajse të gjitha mostrat e gripit të identifikuar janë të tipit A (98%), me një shpërndarje të nëntipeve A(H3) dhe A(H1)pdm09 përkatësisht në 60% dhe 40%. Nga 33 vende që raportuan për intensitetin e aktivitetit të gripit, vetëm Turqia raportoi një nivel të moderuar ose më të lartë, ndërsa në aspektin gjeografik, vetëm Norvegjia dhe Spanja njoftuan për shpërndarje rajonale ose të gjerë të gripit. Në sistemin e mbikëqyrjes për infeksione të rënda akute respiratore (SARI), përqindja e mostrave pozitive për grip ishte 4%, krahasuar me 5% javën e kaluar. Shumica e këtyre ishin të tipit A, me dominim të nëntipit A(H1)pdm09. Për SARS-CoV-2, pozitiviteti në mostrat SARI mbeti në 9%, ndërsa për RSV në 1%. Pavarësisht qarkullimit të vazhdueshëm të këtyre viruseve, normat e vdekshmërisë nga COVID-19 mbeten të ulëta në mesin e vendeve raportuese. Të dhënat e sistemit EuroMOMO tregojnë se vdekshmëria e përgjithshme në vendet pjesëmarrëse është brenda kufijve të pritshëm për këtë periudhë të vitit.

Sa i përket karakterizimit virologjik, gjatë katër javëve të fundit nuk është raportuar aktivitet i ri për gripin në mbikëqyrjen sentinel apo josentinel. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka publikuar tashmë rekomandimet për përbërjen e vaksinave trivalente për sezonin 2025/2026 në hemisferën veriore, duke përfshirë shtamet përfaqësuese të viruseve A(H1N1)pdm09, A(H3N2) dhe B të linjës Victoria, si për vaksinat e bazuara në vezë ashtu edhe për ato të bazuara në kulturë qelizash. Në përgjithësi, situata epidemiologjike e viruseve respiratore në rajonin Evropian mbetet e qëndrueshme, me rritje të moderuar të aktivitetit të gripit sezonal dhe ulje të ngarkesës nga SARS-CoV-2. Monitorimi i vazhdueshëm përmes qendrave sentinel mbetet thelbësor për të ndjekur ecurinë e qarkullimit viral gjatë fillimit të sezonit 2025–2026 dhe për të vlerësuar ndikimin e mundshëm në shëndetin publik.

Burimi: <https://erviss.org/>